

VENDIM
Nr.42, datë 18.1.2012

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR MARRJEN E MASAVE PËR NXITJEN E TË
NXËNIT, TË VIJUESHMËRISË DHE TË PËRPARIMIT TË NXËNËSVE ROMË DHE
EGJIPTIANË TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “NAIM FRASHËRI”, KORÇË, PËR VITIN
SHKOLLOR 2011-2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të 335 (treqind e tridhjetë e pesë) bursave/kuotave ushqimore për nxënësit romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2011-2012.

2. Vlera e bursës/kuotës ushqimore ditore është 72.3 (shtatëdhjetë e dy pikë tre) lekë në ditë për nxënësit, për mbulimin e kostos ushqimore. Vlera e bursës/kuotës ushqimore do t’u ofrohet nxënësve në mjediset e shkollës në formën e shërbimit ushqimor ditor të pakeluar për çdo nxënësit, sipas pasqyrës nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Drejtoria Arsimore Rajonale, Korçë, në fillim të vitit akademik duhet të dërgojë pranë njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Korçë, listën emërore të nxënësve romë dhe egjiptianë, përfitues të bursës/kuotës ushqimore, të detajuar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Një kopje e listës emërore të nxënësve të trajtuar me bursë/kuotë ushqimore dërgohet dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Fondet publike për mbulimin e shpenzimeve për bursat/kuotat ushqimore rialokohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Korçë dhe administrohen nga kjo drejtori.

5. Drejtoria Arsimore Rajonale, Korçë dhe drejtoria e shkollës “Naim Frashëri”, Korçë, organizojnë aktivitete ekstrakurrikulare, me qëllim nxitjen e të nxënësve, të vijueshmërisë dhe të përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë. Këto aktivitete organizohen në përputhje me udhëzimin nr.21, datë 23.7.2010 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në arsimin parauniversitar”.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në programin buxhetor të arsimit 9-vjeçar.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Drejtoria Arsimore Rajonale, Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha